

BIBLIOTEKA
FEMIJVE

L. 20

ROKASTER

Ferit Lamaj

LEPURI QË BËN SHAKA

- FABULA
- VJERSHA SATIRIKE
- EPIGRAME



1-1
L.20

FERIT LAMAJ

LEPURI QË BËN
SHAKA

- fabula,
- vjersha satirike,
- epigrame



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



IRIQI DHE KËRMILLI

Një kërmill mori një gjemb,
thirr e thirr se po i dhemb.

Jep e merr e bot e bot,
mirëpo gjembin s'e nxjerr dot.

Një iriq që nga një drizë
i thotë: — Hipmë mbi kurriz.

Më kot qahesh, kërmill ti!
Ta nxjerr unë që tani!

Andaj jemi shokë e miq...
— Ç'flet kështu, more iriq!?

Më nxjerr gjembin që më shpon,
por... më ngul një batalion...

DELJA DHE RRODHJA

Rrodhja deles iu qep keq,
mirëpo s'iu ngjit dot, për dreq!

I tha delja : — Lodhesh kot;
nuk e sheh, jam qethur sot!...


BUFI DHE MUSHKONJA

Një ditë mushkonja
tek vinte vërdallë,
sheh bufin. Nuk priti,
i sulet në ballë...

Dhe bufi, si bufi,
i flet me shpoti:
— Zzz përse bën,
pse shet trimëri?!

Se unë, moj mike,
t'të flas ashiqare,
nuk pyes për ty,
je e vogël fare!

Kaluan minutat,
seç u ënjt i mjeri...
I vajti në ndihmë
dhe veterineri,



i tha nja dy fjalë,
ashtu si aqik:
«I madh a i vogël —
armiku është' armik.»




KOTELJA DHE THËNGJILLI

Kotelja pa te hiri
një thëngjill e në çast thirri:

— Shih, moj mamì, sa i mirë,
ç'do të luaj me dëshirë!

— Budallaqe, mos e prek,
ky shkëlqen, por keq të djeg...




LIMA DHE TRARI

Lima hante në një tra...
Qeshte trari: — Ha-ha-ha!
Me sa duket, s'paske punë,
po... a e sheh, moj, kush jam unë?!

S'foli lima asnjë fjalë,
veç punonte me ngadalë.
Shkon një orë, dy e tri,
heshti trari për çudi!

E, ç'të fliste më i mjeri:
...Mbeti sa një fije peri.



DRUJA DHE SËPATA

Çante drunë një sëpatë
bam e bam e me inat...

U bë druja çika-çika
i tha bishtit: — Të rëntë pika!

Po ne bashkë jemi fis,
se ti lis e unë lis!


Ndaj mendohem, bëj çudi:
Mirë hekuri, po ti?!

PËRDERISA...

Dhelprën pyetën një ditë:
— Sa rrush ke ngrënë këtë vit?

U thotë dhelpra: — Uh, sa qesha!
Ç'thoni kështu, moj mikështa!

Përderisa s'më kanë zënë,
as dhe një vesh nuk kam ngrënë...



HËNA DHE VETËTIMA

Vetëtima një natë tha:

— Me mua s'bëhet shaka!

Se... kur shfaqem përmbi retë,
ndris më shumë nga dielli vetë.

Foli hëna tërë gaz:

— Të... dëgjohet krisma pas!...




FTOI DHE SHEGA

Na ish ç'na ish... Një ftua
në bahçen pranë shtëpisë.
Shkon krimbi: — Lermë mua
paksa t'të gudulis...

Dhe ftoi, për çudi,
i flet me plot dëshirë:
— Hej, jepi, krimb-o, ti,
sepse më ardhka mirë!

Po krimbi këtë desh:
t'i thoshin veç një fjalë;
pa punës iu përvesh
dhe bëj e bëj kanal...

Një shegë që qe pranë
i flet me ironi:
— Nuk më the, mik e xhan,
hë, si të vjen tani?



BRESHKA DHE GOMARI

Një breshkë ra në lumë
edhe s'po dilte dot;
u lodh e shkreta shumë,
ç'e do, nuk dinte not!

Kaloi andej pari,
siç thuhet në përrallë,
një zog, këlysh gomari,
që hodhi këto fjalë:

— Të mira ka përherë,
ky lumi, more shokë!...
Dhe breshka: — Byrazer,
vazhdo, se.. je në tokë!...



SHARRËTARI DHE DRUJA E SHTREMBËR

Në stivë një dru të shtrembër
sharrëtari e sheh vëngër:

— Nuk kam ç'bëj, duhet t'të marr
e të fus sërish në sharrë.

— Po ç'të keqe të kam bërë?!

— ...Ti më prish stivën të tërë!

SYRI DHE VESHI


Syrit na i thanë prërë:

— Kemi pra, një vend për mik.
Mund të fillosh menjëherë,
le të merresh me... muzikë!

Mirëpo syri, me të drejtë,
i shfaq tjetrit refuzimin:
— Dua punë që të ketë
ndopak lidhje me... shikimin!

— S'të ndihmoj dot kurrresi —
i tha tjetri, edhe qeshi. —
Atë vend që kërkon ti,
s'ka dy ditë e zuri... veshi!






DASHI DHE LIVADHI

Tek kulloste në livadh,
thoshte dashi: — Jam i madh.

Të qeth tullë, miku im;
jam berber e... bëj kërدينë!

Dhe livadhi: — Flet i ziu,
sa të vijë berber bariu...



MOSMIRËNJOHJE

Një majmun këlysh, me ç'thonë,
hidhej, lozte me një djep;
si e zinte me një dorë,
e përplaste tej, në cep.

— Dreq, o dreq, si është kjo botë! —
foli djepi dhe ofshani, —
ky tek unë gjer më sot
seç përkundej nina-nani!...

BARKU DHE SHPINA


U hodh barku: — Kjo barrë dru
është pupël, mor jahu!

.....

Porse koka tha më pas:
— Më mirë shpina le të flasë!...



LEPURI QË BËN SHAKA



Thosh një ditë një lepurush:
— Trim si unë s'është kush!

Shihni ç'më ka ngjarë një herë:
me ç'mbaj mend, ka qenë verë...

Ndiqja balon hap më hap,
ai vrap e unë vrap!

Si e zura në një breg:
ku të dhemb e ku të djeg...

Ndërsa fliste, tej, në stan
lehu balua ham-ham-ham!

Lepurushi pikë e vrer
si rrufe u fut në ferrë.

Kafshët që u ndodhë aty,
u habitën: — Ç'pati ky?!


Po ti ç'pate, bre vëlla?
— Çoku bëjmë dhe... shaka!

PAPAGALLI DHE KANARINA

Një ditë, te lëndina
zogut papagall
i thotë kanarina
në vesh këto fjalë:

— Për nder, miku im,
me ty bëj çudi:
çka foli bilbili
...përsërite ti!

Ja dhe harabeli
nisi cicërimin...
Ti, siç ke zakonë,
fillon... imitimin!




Ç'ma do bukurinë,
kur s'ke një gram mend:
jepe, mor, njëherë
dhe... mendimin tënd!




RROTA E PRISHUR DHE RRUGA

— Drejo rrugë, — thoshte rrota, —
tërë xhunga, tërë gropa!

Ia pret rruga: — S'të kam faj,
ndreju, moj, pastaj u qaj!





BREGORJA NË FUSHË

Dhe bregorja
mbahej rëndë,
dikujt pranë
i shiste mend...
Por dikush
tha këto fjalë:
— Je në fushë,
ndaj... ngjan si mal!

F A J I

Gozhda kur u ngul në derë,
mori shtrembër këtë herë.

Më t'iu sulën: — Faj ke vetë,
je e cilësisë së tretë!

Gjegji gozhda: — Faj s'kam hiç,
a s'e sheh atë çekiç?!

Dhe çekiçi: — Derë, xhan,
edhe unë faj nuk kam!

E ka dora, moj e shkretë;
me ç'di unë, keq godet!

Më pas dora nis të flasë:
— Fajin ti e ke, dërrasë!

Nyje ke, moj e uruar
gozhda ndaj është shtrembëruar!

Ja dhe dera qaj e qaj:
— S'po marr vesh kush paska faj?!



DERRKUCI DHE QENI

Në kopshtin plot me lakra
rojtar na ishte qeni;
derrkuci seç i vete
edhe i thotë: — Ç'kemi?

Për nder, unë bëj çudi,
ç'po ndodh me ty, vëlla!
Një kopsht të tërë ruan
edhe një lakër s'ha?!

Dhe qeni menjëherë:
— S'ha vetë, por... as të tjerët!

MAJMUNI DHE MOLLA

Një majmun dembel qe shtrirë
nën një mollë të arrirë.

Të hipë lart, përtonte shumë:
— E di ç'ka, a s'ia fus gjumë!

Ndonjë kqkërr po ra vetë —
oh, sa mirë, sa mirë do jetë!

Dhe po s'ra, përsëri mirë,
se kam hijen qelepir!...

GJUHA DHË MENDJA

Nxori gjuha një fjalë mbrëmë,
që... nuk është për t'u thënë.

Fjala drejt e në vesh ra.
— Turp, sa turp! — veshi i tha

Iu kthyen: — Mor i shkretë,
s'ka faj gjuha, mendja flet!...

ÇIZMET DHE KËPUCËT

Bashkë kishin marrë një rrugë
çizmet dhe... një palë këpucë.
Ndërsa ecnin me ngadalë,
u dëgjuan këto fjalë:

— S'ju shoh dot, bobo, ç'shëmtim!
Jemi ne, po lustrafin.
Pa kur ecim për merak:
trak-trak-trak, trak-trak-trak.

Çizmet s'folën këtë herë.
Pas pak shi nisi të bjerë
si me shtëmba që nga lart,
u bë llucë, u bë baltë...

Dhe... këpucët, mbetën fare.
Çizmet iknin si më parë:
— Jeni mirë, aty rrini,
se ju prishet lustrafini!

GJILPËRA DHE GËRSHËRA

Thosh gjilpëra: — Më sheh mua,
kaq e vogël, por bëj punë.
Ndërsa ti, ta paça hua,
më kot rron se ha nga unë.

Ia kthen tjetra: — Bëj çudi,
si s'e ditke, moj e mjerë:
copën që merr e qep ti,
unë ta dërgoj të prerë.

Bile... që të dyja ne
do të mbeteshim të gjora;
s'bëjmë dot një hap, për be,
nëse s'do të ishte... dora.


DASHI DHË GOMARI

Gomari dashin kur pa:

— Hajde kokë, kokë! — tha.

Gjegjet dashi: — Mor i shkretë,
shiko kokën që... ke vetë!...





KALI DHE MIZA

Udhës po shkonte një kalë
Një mizë hipur përmbi shalë.
Si kaluan te një urë,
miza nis veten të mburrë:

— E, o kalë, a e pe
kur mbi urë kaluam ne!
U trondit... mirë që s'ra, —
do ish bërë ndonjë hata!

I thotë kali me finesë:
— Duket unë qeshë pengesë!
Do kish rënë me siguri
po të shkoje vetëm ti...

PULA DHE KATUNDARI

Pulës s'i kish dhënë mëngjes
e, ndërkaq po priste vezë.
I tha pula: — Më kot pret,
vezët unë i bëj me sqep!...

GJELI MBËRRAVEC

— Hë, e patë
dramën vallë? —
mburrej gjeli
në kuvend. —
Jam aktor,
aktor i rrallë;
more, unë
të lë pa mend!

— S'na kujtohet, —
tha një qen! —
More, ç'rol
ke pasur ti?
Gjeli tha:
— Në prapaskenë
unë bëja
!...ki-ki-ki!

THOI DHË SYRI

Pastërtinë, —
thoshte thoi, —
trashëgim
e kam nga soi!

Mirëpo syri
në minutë,
ia kthen
urtë e butë:

— Ç'thua, thua,
je ndër mend:
veshit mburrja
soin tënd!

Pasi unë,
more xhan,
t'i shoh mirë,
nën vete... ç'mban!

DY PULAT DHE KOKOSHI

Pulë e bardhë e pul'e zezë
na u zunë për një vezë.

— Qysh s'e ditke, — u hodh njëra, —
këtë vezë unë e bëra!

U ngrit tjetra dhe i tha:
— Është imja, ka-ka-ka...

Një kokosh që u ndodh pranë,
hyn në mes edhe i ndan.

— Fare kot bëni zhurmë:
Vezën... e kam bërë unë!

MURI DHE USTAI

Shiste muri
trimëri:
— Për një gur
s'dua t'ia di!

Një më pak
a një më shumë,
as më ndreq,
as më prish punë!

Dhe ustai:
— Miku im,
për ç'ka fole,
je gabim!

Po t'u hoq
guri në fund —
mjerë ti,
se këmbët tund...

N Ë N V L E R Ë S I M

Misrit i tha gruri:

— Fati e pruri

të njihesh me mua;

bëhemi shokë, ç'thua?!

Tjetri qeshi:

— Ha-ha-ha!

Të rri me një kalama

unë, goxha burrë, —

kurrë!

Foli dhe gruri:

— Lëre, na kënaqe!

Të bie nuri:

je burrë me... mustaqe!



PËLLUMBI DHE BALONA

Thosh balona: — Si unë s'ka,
fluturoj la e më la.

Bile ngjitem gjer te retë
se jam zog, zog i vërtetë!

Por një ditë, ç'kishte ngjarë!
...Nisi era si e marrë.

Doemos që... në minutë,
mjerisht, peri u këput.

Dhe... balona ra me kokë,
që nga lart drejt e në tokë.

Një pëllumb që skenën pa,
nuk duroi, por i tha:

-- Mos u mburr më tjetër herë,
... të mban peri, moj e mjerë!

32



I KTHEHEN DHISË

Një dhi na qe mësuar
të hajë gjethe e fletë,
jo nga të sajat, qoftë mallkuar,
por gjetkë.

Një herë, dy...
e zunë
— Fajin, — u tha, —
s'e kam unë!

— E di, e di!
Herën e parë e pate fajin vetë;
ndërsa tani,
për herë të tretë
i thanë dhisë te stani —
fajin e ka... çobani!..

DIALOG

— Jam orator i mbaruar,
ndoshta s'më keni dëgjuar!

Kur në mbledhje e marr fjalën
gojëhapur e lë sallën!

— Ke të drejtë, padyshim,
për ç'ka thua, miku im.

Kur ti flet, desha të thoja,
ne vërtet na hapet goja...



RRODHI LUMË TEORIA

Kur në bazë shkoi Kujtimi,
e mbaj mend, ja, si tani,
ti u ngrite: — Qarkullimi
të jep forcë, gjallëri...

Ligjërrove nja tri orë,
rrodhi lumë teoria...
— Po ky qenka orator! —
dilnin zërat nga habia.

Pas një viti, përsëri
seç u mblodhëm, miku im.
Kësaj here ishte ti
që do shkoje për freskim.

Nise varg justifikimet...
Por të thanë: — More mik,
e harrove teorinë?
Hë, pra, lidhe me praktikë!...

KUR TË PREKIN TY

Në analizën mujore
fjalën mora edhe unë,
kritikova shokun Fore,
se të meta kish në punë.

Shoku Fore mori zjarr,
shoku Fore u bë prush,
shoku Fore ku kish parë
gjer më sot të tillë dush!

Veç ta shihje në fytyrë
kur u hodh si gjel përpjetë:
si m'i nguli sytë mirë,
nisi të zbrazë bataretë...

Kur kritikën hanë të tjerë,
Shoku Fore mumje rri;
ka të drejtë këtë herë
të shpërthejë në breshëri.

KOPRACI NË DYQAN

Shkon kopraci në dyqan:

— Keni varëse?

— Posi, kam!

Merre, kjo tet' lekë kushton,
është e mirë, s'e shikon!

Dhe kopraci: — Më lirë, s'ka?

— Katër lekshe, mor vëlla!

Dy lekë bën... ajo atje.

— Po më lirë, më lirë s'ke?

— Kam, posi! — shitësi i thotë, —

Urdhëro e merr një... gozhdë!

HUMOR FËMIJNOR

I tha Leta: — Moj Lulzime,
këtë herë në hartim
paske bërë përparime!
— ...Është babi me shërbim!




AH, TURN' I TRETË

Ah, turn' i tretë, ah, turn' i tretë,
t'i mbyllka sytë dhe... kur s'do vetë!
Se si e ndreqi edhe Dudumi,
iku nga freza, e zinte gjumi...

Nuk kish lezet atje, ngahera:
kërkon të rrijë rojë te dera...

Të punojnë, shokët, ashtu të qetë,
se kanë Dudumin mjaft vigjilent!...



SALA, NJË KOMSHIU YNË

Sala, një komshiu ynë,
shkoi rreth njëzet e pesë...
— Hë, o Salë, si e ke synë?
Të erdh' koha për fejesë!

— Do të zgjedh një xhevahir,
të bukur si zanë mali,
dhe të qeshur dhe të mirë
dhe të pastër nga morali...

Vajza-zana paska plot,
por s'i mbushet mendja lehtë.
Dhe kështu, me sot e mot
Sala vajti plot tridhjetë.

— Do të zgjedhësh xhevahir!...
Hë, pra zgjidhe, — i thotë nëna. —
A mos vallë e pret, mor bir,
që të zbresë lart nga hëna?!

Ja, i mbushi dhe dyzet.
I thonë shokët: — More burrë,
pra, lëviz të shkretën, ç'pret!
Më mirë vonë sesa kurrë!...

Vitet ikin, vijnë të tjerë...
Jeta ecën, përparon...
Sala më në fund e merr
një... librezë për pension.

SHUMA DILTE DYQIND MIJË

Më erdh' letra që pa gdhirë,
e lexova pa vonesë:
...E fejuara Zamirë
na qëndiste një kërkesë:

Dua... një qilim të rrallë,
dy jorganë prej atlasi
dhe këpucë, nja tri palë,
por të jenë me takë plastmasi!

Mos lesh fshesën me korent,
edhe rafte të blesh dy;
por dhe stufën më të shtrenjtë...
Ku ta gjesh?.. Punë për ty!

Pres me gaz dhe reflektorin,
që të nxeh shtëpinë, o mik;
ndërsa për televizorin,
të jetë tip «Adriatik».

Nuk e bëmë ne fejesën
qysh në djep porsi dikur,
njëri-tjetrit i dhamë besën
për të mos u ndarë kurrë.

Pra, me shkes nuk u fejuam,
siç fejojeshin më parë,
shoqi-shoqin dashuruam,
ndjenjat tona qenë zjarr!

Do ta zbrazje mirë xhepin
të qe sot kohë e shkuar:
...njëqindmijë në dorë, tim eti
do t'i kishe numëruar!

Ti, i dashur, e di mirë
që këto janë vogëlsira...
Pres përgjigjen me të gdhirë:
Mikja, dora vetë, Zamira.

Mora laps e letër unë,
edhe bëra llogari.
As më pak e as më shumë,
shuma dilte... dyqind mijë!

SIÇ E SHEH, JAM NXIRË CA

Lejen e krijimtarisë
këtë vit shkrimtari Met
tha ta bëjë larg shtëpisë,
ku kish plazh e ku kish det.

Dhe një ditë, tek qe shtrirë,
i shkon njëri: — Ç'kemi, hə!
Me shëndet më qenke mirë,
por.. ke nxirë a s'ke nxirë gjë?

I përgjigjet Meti: — Ç'ka,
siç e sheh... jam nxirë ca.

HUMOR ME PIKATORE

Dembeli:

Të kish paketa veç një cigare
të gjatë sa për... njëzet, or mik,
nuk do të lodhesha unë fare
me fik e ndiz e ndiz e fik!...

Liberali:

Për mua s'ka rëndësi,
ç'cigare është, se qysh, se si!
Për mua, — tha Lymi, —
mjafton që t'i dalë... tymi!

SHKRESA ISH TEPËR SEKRETE

Morët vesh:
Sot në mëngjes
shoku Llesh
humbi një shkresë!

Ku e si
edhe pse ndodhi?
...Gabimisht
në kosh e hodhi.

Ti, or mik,
kërkon të dish:
ajo shkresë,
ç'shkresë ish?!



Qysh ta thotë!
Je në vete:
Shkresa ishte
...mjaft sekrete!...

FJALËN MERR DHE PROKURORI

Në Nju- Jork një narkoman
vrau nënën dhe babanë.

Erdhi puna në gjykatë.
Dëshmitar' ishin nja shtatë.

— Të dënohet, — thanë, — fajtori!
Fjalën merr dhe prokurori:

— Them t'i japim lehtësim
se i shkreti mbet'... jetim!

DIALOG MJEKËSOR PERËNDIMOR

— Hello, mik, a nuk më the,
atë burrin pak më parë,
pse e shtruat?

— He-he-he!

Vetëm për dy mijë dollarë!

— Unë të pyes, ç'kishte Xheku?

— Veç... dy mijë! — gjegjet mjeku.

NJË LLAFOLLOGU

Çdo njeri, or byrazer,
në bisedë me të tjerë
ka dhe veshë të dëgjojë,
ndërsa ti ke... vetëm gojë.

NJË SHITËSI

Edhe sot, si tjetër herë,
kishe një shënim në derë:

«Jam këtu e... jam atje»
e ç'na duhet se ku je?!

S'do mend shumë, ti je diku,
halli është se... s'je këtu!

NJË PESHËNGRITËSI

Je i fortë, o Kasem,
porsi kalë, porsi dem!
Njëqind kile, more mik,
i çon peshë, ashtu, pa frikë!

Brohoret kush të ka parë,
se ti nam lë në çdo garë.
Në shtëpi hallin ta kam:
...atje s'ngre një kilogram.

NJË PIJANIË

- Alo, alo, shoko, dua agjencinë e taksisë!
- Si!... Ku do t'më gjeni mua?
- Pranë gotës së rakisë.

INTRIGANTIT

Për çdo ditë një intrigë
ti ma thur, i dashur mik.
Jam në hall... Këtë herë
kujt duhet t'ia di për nder,
pasi ti, hej miku im,
gjithnjë mbetesh anonim...

DEMBELI

Tek qe shtrirë, tha një natë:
— Po të kisha një sahat,
zgjohesha unë menjëherë.
Por... jo, jo! — pëstaj tha prerë. —
U pendova pra, sërish,
e... kush dreqin e kurdis!

SERVILI DHE DITA E MARTË

Për këtë ditë flasin shumë,
jo qenka ters, jo ku di unë!
Por le të flasë, pra, kush të dojë,
për mua dita e martë të rrojë!

Kur shefi im u ngjit më lart,
e mbaj mend mirë, ka qenë... e martë!

DEMBELI DHE DITA E DIEL

Një herë në javë dukesh, moj mike,
të të flas hapur, ti ne na fike!
Do të qe puna ndryshe, për nder,
sikur të vije nja shtatë herë...

MIKROKOMEDI

- Ceni s'ish aspak sëmurë,
por tri ditë raport i theku.
Ti kësaj ç'i thua, Sulë?
— Do... shëruar vetë mjeku!...

EPIGRAMME PËR VITIN E RI

1) Konservatori

Këtë... çunin do ta pres
vetëm sa për sy e faqe.
Vitit plak, (hej pastë ndjesë,)
nuk i vjen as në... mustaqe.

2) Skeptiku

Unë vë bast që Vit' i Ri
diç do ketë me siguri:
pse s'troket ditën në derë,
por... vjen natën, byrazer!

3) Liberali

— O mik, po vjen Vit' i Ri!
— Hapur e kam këtë derë:
në daç një Vit të vijë,
në daç... dhjetë njëherë!

4) Kopraci

I thanë: — Po vjen Vit' i Ri,
dil e prite edhe ti!
Gjegjet ky: — Jo se nuk dua,
por... kam frikë mos kërkon hua.

5) Oportunisti

Në jetë njeriu zihet keq:
s'di kujt t'ia prishë e kujt t'ia ndreqë!
Pra, jam në hall, se me sa di,
një ikën, por vjen... një i ri!

6) Shpifësi

— E pashë mbrëmë
ish vetë i dytë;
m'u duk si femër,
më plaçin sytë!

Porsa më pa
u drodh i shkreti:
po e pashë unë, unë,
zien... qyteti.

7) Individualisti

Për mua s'ka rëndësi
në vjen a në s'vjen ti.
Për mua në këtë jetë
mjafton që... erdha vetë.

8) Mburraveci

Vitin e Ri, të flas açik,
nuk e mburr se e kam mik.
Por për punë s'ke ç'i thua:
...Më ka ngjarë tërësisht mua.

9) Tifozi

Të qe për mua, Vitit të Ri
s'ia bëja pritjen në shtëpi.
Për shembull, shokë, do ish mirë shumë
sikur ta prisnim në... stadium!

10) Gënjeshtari

Atë natë shoku Llazi
thesin e një viti zbrazti...
Për të ka në kalendar
dhe... 1 prill më 1 janar!...

PËRMBAJTJA

FABULA

Iriqi dhe kërmilli	5
Delja dhe rrodhja	6
Bufi dhe mushkonja	7
Kotelja dhe thëngjilli	9
Lima dhe trari	10
Druja dhe sëpata	11
Përderisa	12
Hëna dhe vetëtima	13
Ftoi dhe shega	14
Breshka dhe gomari	15
Sharrëtarë dhe druja e shtrembër	16
Syri dhe veshi	17
Dashi dhe livadhi	18
Mosmirënjohje	19
Barku dhe shpina	20
Lepuri që bën shaka	21
Papagalli dhe kanarina	22
Rrota e prishur dhe rruga	24
Bregorja në fushë	25
Faji	26

Derrkuci dhe geni	27
Majmuni dhe molla	28
Gjuha dhe mendja	29
Çizmet dhe këpucët	30
Gjilpëra dhe gërshëra	31
Dashi dhe gomari	32
Kali dhe miza	33
Pula dhe katundari	34
Gjeli mburravec	35
Thoi dhe syri	36
Dy pulat dhe kokoshi	37
Muri dhe ustai	38
Nënvlerësim	39
Pëllumbi dhe balona	40
I kthehen dhisë	41

VJERSHA SATIRIKE

Dialog	45
Rrodhi lumë teoria	46
Kur të prekin ty	47
Kopraci në dyqan	48
Humor fëmijhor	49
Ah, turni i tretë	50
Sala, një komshiu ynë	51
Shuma dilte dyqind mijë	53
Siç e sheh, jam nxirë ca	55
Humor me pikatore	56
Shkresa ish tepër sekrete	57
Fjalën merr dhe prokurori	58
Dialog mjekësor perëndimor	59

EPIGRAME

Një llafollogu	63
Një shitësi	64
Një peshëngritësi	65
Një pijanik	66
Intrigantit	67
Dembeli	68
Servili dhe dita e martë	69
Dembeli dhe dita e diel	70
Mikrokomedi	71
Epigrame për Vitin e Ri	72

The following is a list of the names of the
 persons who have been appointed to the
 various offices of the Board of
 Education for the year 1870.
 The names are arranged in alphabetical
 order of their surnames.
 The names of the members of the
 Board are as follows:

MEMBERS OF THE BOARD

The following is a list of the names of the
 persons who have been appointed to the
 various offices of the Board of
 Education for the year 1870.
 The names are arranged in alphabetical
 order of their surnames.
 The names of the members of the
 Board are as follows:

Lamaj, F.

Lepuri që bën shaka. Fabula,
vjersha satirike, epigrame.

(Red.: R. Vozga] T., «Naim Frashëri»,
1985.

80 f. me il.

(Bm): 891.983 - 191+

891.983-17

+891.983 - 193.2

(Bv): 891.983 - 1

L.20

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re —
Tiranë 1985